




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	01-1488/14
Broj stranica	
Nr. pages	
03	PRISHTINË
Data Datum Date 25-04-2014	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	25.04.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Faruk HAJRIZI, Kryeshef ekzekutiv – Kompani Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtësor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funkcionit publik



Inderuar,

Në mbështetje të nenit 5 (parografi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (parografi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga Faruk Hajrizi, kryeshef ekzekutiv në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit Mitrovica (në tekstin e mëtejshmë KUR Mitrovica), me numër të protokolit 03-1476/14, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit nëse z. Rasim Veseli nënshkruan kontratë me "KUR Mitrovica" duke pasur parasysh se personi në fjalë është dhëndri i tij.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve qe kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Në bazë të nenit 6 të këtij ligji pozita juaj si kryeshef ekzekutiv në “KUR Mitrovica” hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Bazuar në nenin 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Ndërsa, Agjencia kundër Korrupsionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, në pajtim me dispozitat në fuqi dhe mandatin e përcaktuar ligjor, duke i marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me konfliktin e interesit lidhur me këtë rast, vlerësojmë se:

Punësimi i z. Rasim Veseli në “KUR Mitrovica” paraqet konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik. Kjo për faktin se z. Veseli, ashtu siç na keni informuar ju, është dhëndri i kryeshefit ekzekutiv të kësaj ndërmarrjeje.

Ligi për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në nenin 6 përcakton se konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik. Më tej, ky ligj në nenin 9 parashev veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik. Në paragrafin 1 pika 9 të këtij nenii parashihet se zyrtarit të lartë i ndalohet të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm; ndërsa 10 e këtij paragrafi parashev që zyrtarit të lartë i ndalohet të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik.

Po ashtu Kodi i Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike i cili ka për qëllim t'i udhëzojë të punësuarit dhe drejtoret e Ndërmarrjeve Publike se si të veprojnë me integritet, ndërgjegje të pastër dhe mendim të mirë, e ka të rregullur në mënyrë detajore çështjen e konfliktit të interesit.

Në nenin 7 (pika 2) të këtij kodi, ndër të tjera parashihet se konflikti i interesit paraqitet kur interesat personale të individëve ndërhyjnë ose bien ndesh në ndonjë mënyrë – ose duket se ndërhyjnë apo bien ndesh me interesat e Ndërmarrjes.

Më tej, ky kod jep shpjegime se një situatë e konfliktit të interesit mund të paraqitet kur një punëtorë ose drejtor, ndërmerr veprime ose ka interesa (familjare, financiare, politike dhe sociale) që mund ta bëjnë të vështirë përbushjen e punës së Ndërmarrjes në mënyrë objektive dhe efikase.

Sipas këtij kodi konflikt i interesit mund të paraqitet edhe kur një i punësuar ose anëtar i familjes së tij/saj pranon përfitime personale jo të duhura si rezultat i pozitës së tij/saj në Ndërmarrje, pa marrë parasysh nëse ato përfitime janë pranuar në mënyrë direkte apo indirekte. Për të sqaruar si mund të ndodh konflikti i interesit në praktikë kod i një fjalë jep disa shembuj praktik ku ndër të tjera thuhet se konflikti i interesit mund të paraqitet kur një punëtorë:

- *ka një anëtar të familjes në Ndërmarrje dhe ai person ose anëtar i familjes është drejtor apo zyrtar i Ndërmarrjes;*

Përveç këtyre dispozitave të përmendura, po ashtu edhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka paraparë situatat e konfliktit të interesit si dhe masat që mund të merren në rast se shkelen këto dispozita. Në nenin 424 (paragrafi 1, 3 dhe 4) shprehimisht thuhet se:

Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Për qëllime të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit për një çështje zyrtare.

Për qëllime të këtij neni, shprehja “çështje zyrtare” nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër.

Në bazë të kësaj që u tha më lart, vlerësojmë se, lidhja eventuale e kësaj kontrate me këtë ndërmarrje është e ndaluar pikërisht me dispozitat e lartpërmendura.

Andaj, konform kësaj, iu rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinioni, që të parandaloni konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.